

FJALA E DEPUTETES ENSLEMLVERA ZAKE

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Te nderuar qytetarë,

Dua të them vetëm disa fjalë, sipas opinionit tim, lidhur me buxhetin në emër të të gjithë qytetarëve që përfaqësoj, duke iu referuar kolegëve të opozitës,. Kur flasim për buxhetin e shqiptarëve, nuk ka dhe nuk duhet të ketë mikropartitizma, interesa partiake apo kapriço politike që shfaqen me kundërshti. Kur flasim për buxhetin e shqiptarëve primare nuk është politika personale, por interesi i shqiptarëve në një periudhë të vështirë e sfidante për gjithë ekonominë globale. Si çdo arritje tjetër e njerëzimit dhe e kapacitetit të individit, edhe financat e kanë prejardhjen thellë, para erës sonë, që në thelb do të thotë të menaxhosh të ardhurat e familjes tënde ose në miniaturë të menaxhosh të ardhurat e një shteti. E meqë shqiptarët na besuan me votën e tyre qeverisjen, na kanë besuar edhe financat. Prandaj, të bëjmë më të mirën tonë për të rimëkëmbur ekonominë dhe të punojmë fort duke i hapur rrugën më të mirit, duke trokitur derë më derë për të dëgjuar problemet e qytetarëve dhe për të bërë atë që meritojnë fëmijët tanë dhe familjet shqiptare. Për të kaluar te rendi i ditës, te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane, dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020”, ky është një akt shumë i rëndësishëm në kuadër të marrëveshjes IPA II, 2014-2020, pasi siguron financimin e projekteve për vitin 2020. Programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni e Veriut - Shqipëri synon dhënien e kontributit për zhvillimin socialekonomik të zonave ndërkufitare dhe rritjen e bashkëpunimit midis të dyja vendeve, nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Përfitues të këtij programi në vendin tonë janë: qarku i Dibrës, qarku i Elbasanit dhe rajoni i Korçës. Në Maqedoninë e Veriut përfitues janë rajoni i Pelagonias, rajoni i Pollogut dhe rajoni Jugperëndimor. Në fokus mbeten prioritetet si: -Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore. -Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve. -Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. Për këtë program, financimi i të cilit është parashikuar në vlerën prej 11,9 milionë eurosh, deri tani janë nënshkruar gjashtë marrëveshje financimi midis palëve, të cilat trajtojnë alokimet për vitet 2014-2019. Alokimet e mëtejshme do të trajtohen në marrëveshjet e tjera të financimit midis palëve. Fondet për asistencë teknike, në kuadër të këtij programi, janë 1,19 milionë euro për të dyja vendet dhe përbëjnë 10 % të buxhetit të përgjithshëm të programit, që do të përdoren për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të programit nga strukturat kombëtare dhe ato teknike. Për vitin 2020 vlera e financimit të

programit, që do të sigurohet nga kjo marrëveshjeje, është 1,8 milionë euro për të dyja vendet, nga të cilat 1,53 milionë euro janë kontribut i Bashkimit Europian për të dyja vendet, dhe 270 milionë euro janë bashkëfinancimi kombëtar i të dyja vendeve. Përfitimi i palës shqiptare nga financimi total për këtë marrëveshje është 900 mijë euro. Raporti për financimin e çdo projekti, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, është në masën 85 për qind nga granti i BE, dhe 15 për qind nga bashkëfinancimi kombëtar. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, strukturat rajonale e vendore të vendit tonë dhe të Maqedonisë së Veriut do të realizojnë disa projekte në zonat ndërkufitare të të dyja vendeve, në fushën sociale dhe ekonomike. Përzgjedhja e projekteve bëhet sipas një procesi transparent aplikimi dhe projektet fituese përcaktohen pas vlerësimit të aplikantit gjatë fazës së thirrjes për projektpropozimet. Nga këto programe do të përfitojnë institucionet shtetërore buxhetore, si dhe organizata dhe shoqata jofitimprurëse. Prioritete për këtë program përbëjnë fusha të tilla, si: krijimi i partneriteteve ndërkufitare, autonomia vendore dhe mundësitë e barabarta, mosdiskriminimi i minoriteteve dhe i kategorive të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore e të tjera. Për zbatimin me sukses të këtij programi rëndësi të veçantë ka rritja e mundësive dhe e kapaciteteve në vendin tonë për hartimin dhe përthithjen e projekteve më të mira, si dhe zbatimin me korrektësi të tyre. Ky projektligj është votuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave nga të gjithë deputetët e pranishëm në mbledhje, prandaj ftoj të gjithë kolegët për ta miratuar atë. Faleminderit!